


PIKA E GJASHTË E RENDIT TE DITES



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipality Viti/na

Në bazë të nenit 58, shkronja h, nenin 17, paragrafi 1, shkronja (b), të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28/2008", e në mbështetje të nenit 5, paragrafi 1.2, pika 1.2.1, nenit 6, paragrafi 1.2, pika 1.2.1, nenit 10, paragrafi 2, pika 2.2, nenit 11 dhe nenit 15 të Ligjit Nr.04/L-174 për Planifikim Hapësinor "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.30/2013" dhe Udhëzimit Administrativ (MMPH) Nr. 11/2015 mbi elementet dhe kërkesat themelore për hartimin, zbatimin dhe monitorimin e Planeve Zhvillimore Komunale, si dhe Udhëzimit Administrativ (MMPH) Nr. 08/2017 për normat teknike të planifikimit hapësinor dhe Vendimit për dhënien e pëlqimit për miratimin e Planit Zhvillimor Komunal të Komunës së Vitisë 2023-2031 Nr. 5851-2/23 të datës 08.012.2023 nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, nenit 50, paragrafi 50.1, pika 1 të Statutit të Komunës së Vitisë 01 Nr. 013/491, të datës 21.04.2011, kryetari i Komunës së Vitisë paraqet këtë:

PROPOZIM V E N D I M

Për miratimin e Planit Zhvillimor Komunal 2023-2031 të Komunës së Vitisë

Neni 1

Me këtë propozim vendim, kryetari i Komunës i propozon Kuvendit të Komunës së Vitisë, që të bënë miratimin e Planit Zhvillimor Komunal" për Komunën e Vitisë për periudhën 8 (tetë) vjeçare 2023-2031 (në tekstin e mëtejshëm PZHK), është projekt-plan multi-sektorial i cili përcakton caqet afatgjata të zhvillimit ekonomik, social dhe hapësinor duke përfshirë planin për zhvillimin e zonave urbane dhe rurale për tërë territorin e Komunës së Vitisë.

Neni 2

2.1 "Plani Zhvillimor Komunal i Vitisë 2023-2031" përcakton vizionin, parimet, objektivat dhe prioritetet e zhvillimit strategjik për tërë territorin e Komunës, mbi të cilat do të bazohet hartimi i Hartës Zonale të Komunës së Vitisë.

2.2 Pjesë përbërëse e këtij propozim-vendimi është "Plani Zhvillimor Komunal i Vitisë 2023-2031" i hartuar nga Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit e Komunës së Vitisë, duke u bazuar në dispozitat e Ligjit Nr.04/L-174 për Planifikim Hapësinor "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 30/2013", Udhëzimit Administrativ (MMPH) Nr. 11/2015 mbi elementet dhe kërkesat themelore për hartimin, zbatimin dhe monitorimin e Planeve Zhvillimore Komunale si dhe Udhëzimit Administrativ (MMPH) Nr. 08/2017 për normat teknike të planifikimit hapësinor dhe Vendimit për dhënien e pëlqimit për miratimin e "Planit Zhvillimor Komunal i Komunës së Vitisë 2023-2031" Nr. 5851-2/22 të datës 08.12.2023 nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës në Prishtinë.

2.3 "Plani Zhvillimor Komunal i Komunës së Vitisë 2023-2031" përmban pjesën tekstuale dhe grafike, Vendimin Nr. 21-3628/21 të datës 13.10.21 për Pëlqimin Mjedisor të Raportit për Vlerësimin Strategjik Mjedisor dhe Raportin e shqyrtimit publik e që janë pjesë përbërëse e këtij propozim vendimi.

Neni 3

Të gjitha planet tjera komunale që nuk janë në kundërshtim me "Planin Zhvillimor Komunal të Vitisë 2023-2031" mbesin në fuqi deri në miratimin e Hartës Zonale të Komunës të Komunës së Vitisë.

Neni 4

Për zbatimin e këtij propozim vendimi do të kujdesen të gjitha organet e Komunës së Vitisë, nën mbikëqyrjen e Kryetarit të Komunës.

Neni 5

Me hyrjen në fuqi të këtij propozim vendimi shfuqizohet vendimi me numër të protokollit 01-013/126 i datës 07.02.2011 për miratimin e Planit Zhvillimor Komunal 2010-2020+.

Neni 6

Ky propozim vendim hyn në fuqi ditën e miratimit nga Kuvendi i Komunës së Vitisë.

Kryetari i Komunës së Vitisë
Sokol Haliti

